



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 04-610/01-5847/25
Kaçanik, 28.03.2025

Ne baze të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (h) te Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 20 pika I, te Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032, nenit 5 pika (d) te Ligjit për Arsimin ne Komunitat Republikës se Kosovës Nr.03/L- 068, te nenit 6 pika 3 paragrafit I, Neni 14 Përbërja e komisionit përzgjedhës me paragrafi 8.1 dhe 8.2 të Rregullore (QRK) - Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, të Propozim Vendimit të Drejtorisë së Arsimit 04 Nr. 610/01-5847/25 prej datës 10.03.2025, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 28 mars 2025, mori këtë:

VENDIM

Për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor të institucioneve arsimore

1. Me këtë Vendim, Komisionit përzgjedhës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për kandidatët që konkurrojnë për pozitën Drejtor dhe Zëvendës drejtor të institucioneve Arsimore në Komunën e Kaçanikut, në IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" në Kaçanik, SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik, SHFMU "Jusuf Gërvalla" në Biçec dhe SHFMU "7 Shtatori" në Begracë, në këtë përbërje:

- 1.1 Gafurr Guri, Kryetar i komisionit, drejtues i ulët në DA;
- 1.2 Florie Zeneli - Berisha, Anëtare, drejtoreshë në SHFMU "Idriz Seferi"; dhe
- 1.3 Një(l) përfaqësues i MASHTI-të, anëtar.

2. Komisioni përzgjedhës është ad hoc, mandati i tij përfundon me nxjerrjen e vendimit/eve përfundimtare për përzgjedhjen e kandidatëve në pozitën e kërkuara me konkurs.

3. Komisioni përzgjedhës do të veprojë sipas udhëzimeve të parashikuara, respektivisht Rregullore (QRK) - Nr.19/2024.

4. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit (përmes kësaj drejtorie, njoftohen anëtarët e komisionit).

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
QESTINA KAÇANIK

Data: 22.04.2025 Vendi: KAÇANIK

Numri: 01 Shitja: 6061-8737-1



8-1550 DALJE

16.04.2025

1

Dr. Velibor Dostaj, Prishtinë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretar/Office of the General
Secretary

REFERENC-Ë:	8-1550
PËR/ZA/TO:	Kryetarit të Komunës së Kaçanikut Njësia për Administrimin e Dokumenteve ne MAPL
CC:	Jeton Qela, sekretar i përgjithshëm në MAPL Erblin Hetemi, U.d. udhëheqës i departamentit ligjor dhe monitorim të komunave MAPL
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Fadile Dyla, sekretare e përgjithshme/MASHTI
NGA/OD/FROM:	Nazmije Maxhuni, zyrtare e lartë ligjore/MASHTI Elhame Shabani, zyrtare e lartë ligjore/MASHTI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Kaçanikut Vendimin 01/Nr.04-610/01- 5847/25 dt.28.03.2025

Të nderuar,

Lidhur me kërkesën për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Kaçanikut: Vendimin 01/Nr.04-610/01-5847/25 dt.28.03.2025 për emërimin e Komisionit përzgjedhes për drejtorë dhe zëvendës drejtorëve të Institucioneve arsimore, opinionin ynë është si në vijim:

Në bazë të nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr:19/2024 Për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, mendojmë se ky Vendim është në përputhje me këtë Rregullore.

Me respekt!